



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM
Nr. 126, datë 10.09.2019

PËR VLERËSIMIN DHE PIKËZIMIN E KANDIDATURËS SË ZNJ. MARSIDA
XHA FERLLARI NË VENDIN VAKANT PËR GJYQTAR NË GJYKATËN
KUSHTETUESE, TË SHPALLUR NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS NË DATËN
04.03.2019

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

Ardian Dvorani	- Kryetar
Vitore Tusha	- Zëvendëskryetare
Arta Marku	- Anëtare
Margarita Buhali	- Anëtare
Fatjona Memçaj	- Anëtare
Fatri Islamaj	- Anëtar/Relator
Eriol Roshi	- Anëtar

Asistuar nga sekretare **Dorina Dulaj**,

Me praninë e **Avokates së Popullit, znj. Erinda Ballanca**, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- **z. Bledar Dervishaj**, përfaqësuesi i autorizuar i Presidentit të Republikës, në mbledhjen e datës **07.08.2019 dhe 09.08.2019**, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

**KANDIDATE PËR GJYQTARE
NË GJYKATËN KUSHTETUESE:** **Znj. Marsida Xhaferllari**

OBJEKTI: **Vlerësimi dhe pikëzimi i kandidaturës së znj. Marsida Xhaferllari, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019**

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi shqyrtoi relacionin e anëtarit relator të Këshillit, **z. Fatri Islamaj**, dëgjoi mendimin e paraqitur nga **Avokati i Popullit, znj. Erinda Ballanca**, në cilësinë e vëzhguesit të përhershëm në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatës, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me Vendimin nr.111, datë 06.08.2019, ka vendosur lejimin e kandidimit të kandidatës Marsida Xhaferllari për gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019, për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të gjyqtarës Altina Xhoxhaj.

2. Në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 8577/2000 dhe të ligjit nr. 115/2016, si edhe atyre të Kreut IV (pikat 27-38) të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, anëtari i Këshillit, z. Fatri Islamaj, në cilësinë e relatorit të vendit vakant të treguar në pikën 1 të këtij Vendimi, ka realizuar veprimet përgatitore të procedurës së vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve, njëkohësisht me procedurat e verifikimit të tyre.

3. Bazuar në aktet që janë dorëzuar nga kandidatja Marsida Xhaferllari në momentin e kandidimit dhe dhe akteve e dokumenteve të tjera që janë administruar gjatë fazës përgatitore të procedurës së vlerësimit, nga anëtari i Këshillit relator i vendit vakant në të cilën kjo kandidatë ka paraqitur kandidaturën e saj, hartoi relacionin përkatës për gjetjet në procedurën e përzgjedhjes dhe të vlerësimit të kësaj kandidatë për gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese.

4. Në përfundim të procedurave të verifikimit dhe vendimeve të dhëna për lejimin ose ndalimin e kandidimit për të gjithë kandidatët në këtë vend vakant, relatori Fatri Islamaj ka njoftuar Kryetarin dhe ka paraqitur për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit, relacionin dhe dokumentacionin e përgatitur për secilin kandidat të vendit vakant lidhur me procedurën e përzgjedhjes dhe vlerësimit të kandidaturave.

5. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me Vendimin nr. 112, në datën 07.08.2019 ka vendosur fillimin e procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve të lejuar për vendet vakante, si më poshtë:

- a) Vendi vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018.
- b) Vendi vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, shpallur nga Kuvendi, në datën 12.02.2018.
- c) Vendi vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 04.03.2019.
- c) Vendi vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, shpallur nga Kuvendi, në datën 04.03.2019.

6. Gjithashtu, me vendimin nr. 113 dhe nr. 114 të datës 07.08.2019, Këshilli ka miratuar kalendarin e intervistave me kandidatët e lejuar, si edhe listën e ekspertëve për gjuhët e huaja për dhënien e mendimit teknik për nivelin e zotërimit të tyre nga kandidatët.

7. Në mbledhjen e tij të datave 07.08.2019 dhe 09.08.2019, Këshilli shqyrtoi relacionet dhe procedurat e ndjekura gjatë veprimeve përgatitore nga secili relator si edhe plotësimin e dokumentacionit të paraqitur për vlerësim lidhur me secilin kandidat. Gjithashtu, Këshilli dëgjoi edhe mendimin e Avokatit të Popullit që, në thelb, nuk paraqiti vërejtje lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për përgatitjen e dokumentacionit të kandidatës Marsida Xhaferllari

8. Pas këtyre veprimeve, në vijim të mbledhjes, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, ka zhvilluar procedurën e intervistës me kandidatët e lejuar, mbi motivimin e kandidimit dhe nivelin e zotërimit të gjuhëve të huaja, për katër vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese, të treguara në pikën 5 të këtij Vendimi.

9. Intervista mbi motivimin e kandidimit dhe nivelin e zotërimit të gjuhëve të huaja me kandidaten e lejuar, znj. Marsida Xhaferllari, kandidatë për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të treguar në shkronjën “c” të pikës 5 të këtij Vendimi, u zhvillua në datën 09.08.2019.

10. Lidhur me nivelin e zotërimit të gjuhës angleze, të përzgjedhur nga vetë kandidatja e lejuar znj. Marsida Xhaferllari, në vijim të bisedës së zhvilluar në këtë gjuhë gjatë një pjese të intervistës, Këshilli i është paraqitur edhe mendimi me shkrim nga ekspertja e caktuar me vendimin nr. 113 datë 07.08.2019, Dr. Adelina Albrahimi, pedagoge e brendshme e gjuhës angleze, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

11. Në përfundim të intervistës, bazuar në të dhënat e nxjerra nga biseda mbi motivimin e kandidimit, mendimin e ekspertës për nivelin e zotërimit të gjuhëve të huaja, si edhe bazuar në aktet dhe dokumentet që janë dorëzuar nga kandidatja Marsida Xhaferllari në momentin e paraqitjes së kërkesës për kandidim, dokumente të paraqitura prej saj sipas kërkesave të Këshillit, si edhe shkresa dhe të dhëna të tjera kërkuara apo të ardhura zyrtarisht nga institucione të ndryshme, Këshilli ka vënë në bisedim vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatës Marsida Xhaferllari për secilin nga kriteret e vlerësimit të përcaktuara:

- a) në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës;
- b) në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të plotësuara, për aq sa nuk përcaktohet ndryshe në këto dispozita, me kriteret e përgjithshme të vlerësimit të parashikuara në nenin 240 të ligjit nr. 115/2016;
- c) në detajimin e mëtejshëm të kriterëve ligjore të posaçme dhe të përgjithshme të vlerësimit dhe përcaktimit më të hollësishëm të peshës specifike të tyre në pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve të treguar në Kreun II, në Kreun V dhe në Shtojcën 1 të Vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
- ç) në shpjegimet e hollësishme lidhur me metodologjinë mbi të cilin bazohet në vlerësimi dhe caktimi i pikëve të miratuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019 “Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese”.

A. Meritat profesionale – Historiku Arsimor dhe Profesional

Vjetërsia në profesion

12. Në shkronjën “a” të pikës 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, përcaktohet si kriter vlerësimi “*Vjetërsia në profesion*”. Ndërkohë që, sipas nenit 125 të Kushtetutës dhe nenit 7/a pika 2 shkronja “a” të ligjit nr. 8577/2000, përbën kusht lejimi kandidimi që kandidati të ketë së paku 15 vjet përvojë profesionale si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor të së drejtës, nëpunës (jurist) të nivelit të lartë në administratën publike.

13. Prandaj, Këshilli vlerëson me pikë kohëzgjatjen për më shumë se 15 vjet të këtyre fushave të përvojës profesionale të secilit kandidat, në maksimum deri në 4 pikë, sikurse orientohet në tabelën e përshkallëzuar të pikëzimit të vjetërsisë në profesion të treguar në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

14. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidatja Marsida Xhaferllari, ka ushtruar veprimtaritë profesionale si më poshtë:

- a) Gjyqtare, për periudhën “*Tetor 1999 – Dhjetor 2007*”, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier;
- b) Këshilltare e Ministrit të Drejtësisë, për periudhën “*Dhjetor 2007 – Gusht 2008*”, pranë Ministrisë së Drejtësisë;
- c) Drejtore e Përgjithshme e Kodifikimit, për periudhën “*Shtator 2008 – Gusht 2011*”, pranë Ministrisë së Drejtësisë;
- ç) Drejtore e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë, për periudhën “*Gusht 2011– Janar 2013*”, pranë Ministrisë së Drejtësisë;
- d) Kryeinspektore, për periudhën “*Janar 2013 – Aktualisht*”, pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

15. Mbështetur në të dhënat e sipërcituara, rezulton se në rastet e veprimtarive sipas shkronjës “a”, “c”, “ç” dhe “d” të pikës 14, kandidatja Marsida Xhaferllari ka ushtruar veprimtari profesionale në fushat e përcaktuara sipas nenit 125 të Kushtetutës dhe nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000. Prandaj, në momentin e vlerësimit, kjo kandidate ka gjithsej rreth **19 vjet dhe 1 muaj** vjetërsi në punë.

16. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “vjetërsia në profesion”, nisur nga ushtrimi i veprimtarive profesionale në një kohëzgjatje prej **19 vjet dhe 1 muaj**, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidaten Marsida Xhaferllari me **2 (dy) Pikë**.

Historiku Arsimit

17. Në shkronjën “d” të pikës 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, përcaktohet si kriter vlerësimi edhe ecuria gjatë kryerjes së arsimit të lartë me një notë mesatare jo më pak se 8 ose të barasvlefshme me të, ndërkohë që edhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016 kërkon të vlerësohen rezultatet gjatë studimeve në ciklet e arsimit të lartë.

18. Prandaj, Këshilli vlerëson me pikë ecuria gjatë kryerjes së arsimit të lartë me një notë mesatare jo më pak se 8 ose të barasvlefshme me të të secilit kandidat, sipas përshkallëzimit me 1 pikë të notës mesatare mbi 8 dhe me 2 pikë të notës mesatare mbi 9, sikurse orientohet në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

19. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidatja Marsida Xhaferllari ka përfunduar studimet dhe është diplomuar në vitin 1997 si juriste, në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë.

20. Sipas certifikatës së notave të lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës dhe vetëdeklarimi i bërë nga kandidatja Marsida Xhaferllari, rezulton se ka përfunduar studimet universitare me notë mesatare **9.7**.

21. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “historiku arsimor”, nisur nga nota mesatare **9.7** e arritur gjatë studimeve dhe diplomimit në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidaten Marsida Xhaferllari me **2 (dy) Pikë**.

Kualifikime Pasuniversitare

22. Në pikën 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe pikat 1 e 4 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, përcaktohen si kritere vlerësimi pasja e titujve akademikë, gradave shkencore, ecuria dhe kryerja kualifikimeve pasuniversitare, studimeve dhe specializimeve afatgjata (përfshirë Shkollën e Magjistraturës), si edhe kryerja e trainimeve afatgjata dhe afatshkurtra në fushën e të drejtave kushtetuese, të drejtave të njeriut, si edhe në fusha të tjera të së drejtës.

23. Prandaj, në zbatim të ligjit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson me pikë llojin e titujve akademikë dhe gradave shkencore, llojin, kohëzgjatjen, fushën dhe vendin e kryerjes së kualifikimeve pasuniversitare, studimeve, specializimeve dhe trainimeve të kandidatëve, duke pasur parasysh shpërndarjen e pikëve sipas vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe orientimet që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

24. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidatja Marsida Xhaferllari ka ndjekur Shkollën e Magjistraturës në periudhën Tetor 1997 deri në vitin 2000 dhe ka marrë titullin “*Magjistrat Gjyqtare*”.

25. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “*studime afatgjata*”, nisur nga marrja e titullit “*Magjistrat Gjyqtare*” në Shkollën e Magjistraturës, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidaten Marsida Xhaferllari me **4 (katër) Pikë**.

26. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidatja Marsida Xhaferllari ka ndjekur 31 veprimtari trainimi afatshkurtra dhe disa për një periudhë mbi dy javore, në një pjesë të madhe të tyre në Danimarkë, Itali, Poloni, Këshilli i Europës, Shqipëri etj. Tematika e këtyre veprimtarive lidhet me fusha të ndryshme të së drejtës materiale dhe procedurale, disa prej të cilave edhe me të drejtat e njeriut, procesin e rregullt ligjor, të drejtën kushtetuese europiane etj.

27. Duke pasur parasysh numrin, llojin, kohëzgjatjen dhe tematikat e veprimtarive trainuese të ndjekura nga kandidatja Marsida Xhaferllari, për këtë kriter ligjor vlerësimi Këshilli çmoi ta vlerësojë me **2 (dy) Pikë**.

Njohja e gjuhëve të huaja

28. Në shkronjën “c” të pikës 4 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, përcaktohet si kriter vlerësimi niveli i zotërimit të gjuhëve të huaja.

29. Prandaj, në zbatim të ligjit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson me pikë llojin dhe numrin e gjuhëve të huaja, si edhe nivelin e zotërimit të tyre nga ana e kandidatëve, duke pasur parasysh sasinë e pikëve maksimale përkatëse sipas vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe orientimet që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

30. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, kandidatja Marsida Xhaferllari deklaroi se zotëron tre gjuhë të huaja, Anglisht, Italisht dhe Frengjisht. Sipas deklaratës së kandidatës niveli i zotërimit të të dy gjuhëve të huaja të para është “rrjedhshëm” dhe “shumë mirë” në të tre komponentët: të kuptuarit, të folurit dhe me shkrim, ndërsa për gjuhën e tretë niveli i zotërimit është “pak”. Për njohjen e gjuhëve të huaja nuk janë paraqitur dokumente të lëshuara nga institucione arsimore për zotërimin e tyre.

31. Gjithashtu, gjatë intervistës së zhvilluar me Këshillin në datën 09.08.2019, për verifikimin e shkallës së zotërimit të gjuhës angleze, kandidatja Marsida Xhaferllari zhvilloi edhe bisedën me ekspertin e zgjedhur nga Këshilli, dr. Adelina Albrahimi. Në mendimin me shkrim të depozituar pranë Këshillit, ekspertja e njohurive të gjuhës angleze, në thelb, ka ardhur në përfundimin se kandidatja Marsida Xhaferllari shpalosi aftësi të shkëlqyera të të kuptuarit të gjuhës angleze, kupton pa vështirësi informacion teknik kompleks të lidhur me fushën ligjore, komunikon rrjedhshëm në gjuhën angleze dhe demonstroi aftësi të përdorimit të strukturave komplekse gramatikore dhe të ekspozimit ndaj gjuhës angleze, duke sugjeruar vlerësimin me **3 (tre) Pikë**.

32. Për këto arsye, duke pasur parasysh mendimin me shkrim të ekspertes së vlerësimit të shkallës së zotërimit të gjuhës angleze me **3 (tre) Pikë**, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidaten Marsida Xhaferllari për këtë kriter ligjor vlerësimi, në total me **3 (tre) Pikë**.

B. Meritat profesionale – Kualifikimi i Përgjithshëm Profesional

33. Në shkronjën “ç” të pikës 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, në lidhje me kualifikimin e përgjithshëm profesional, përcaktohen si kritere vlerësimi, në bazë të treguesve shkencorë, performanca e dalluar dhe rezultatet e larta në ushtrimin e profesionit, që mbështetet ndërmjet të tjerave në botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike, në produktet profesionale sipas profileve të ushtrimit të profesionit, rezultatet e vlerësimit profesional dhe të etikës të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, ose rezultatet e dallueshme të arritura gjatë përvojave të tyre të punës e që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën përkatëse.

34. Prandaj, në zbatim të ligjit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson me pikë si sasinë ashtu edhe cilësinë e rezultateve profesionale, me një fokus të veçantë tek cilësia. Në këtë mënyrë, bazuar në të dhënat e mundshme të disponueshme për vlerësim, mbahen parasysh

sasia e pikëve maksimale prej 30 pikësh sipas vendimit normativ nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe orientimet për caktimin e mundshëm të një maksimumi prej 25 pikësh për sa i përket vlerësimit cilësor dhe të një maksimum prej 5 pikësh për vlerësimin e sasisë së rezultateve profesionale sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

35. Në rastin e kandidatës Marsida Xhaferllari, Këshilli shqyrtoi dokumente profesionale dhe të dhënat që mund të disponoheshin nga veprimtaria e saj profesionale, si edhe nga kontributet e tjera profesionale të kësaj kandidateje në veprimtari të ndryshme, përfshirë publikime apo punime e artikuj shkencorë.

36. Për sa i përket vlerësimit sasior, krahas të dhënave që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidatja, Këshilli administroi dhe shkresën e dt. 11.10.2016 të Presidentit të Republikës i cili në cilësinë e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka vlerësuar punën e Kryeinspektore Marsida Xhaferllari. Sipas kësaj shkrese rezultoi se ajo është vlerësuar për aftësinë e saj në për të përmbushur në cilësi detyrat e ngarkuar nga Ligji dhe vendimet e KLD-së dhe ka treguar saktësi dhe shpejtësi të kënaqshme për realizimin e detyrave.

37. Kjo kandidate rezultoi se ka përballuar një volum shumë të lartë pune gjatë periudhës që ka qenë gjyqtare, si edhe në pozicionet e Drejtores së Përgjithshme të Drejtorisë së Kodifikimit dhe asaj të Çështjeve të Drejtësisë, periudha në të cilat rezultoi të jetë angazhuar si përfaqësuese e Këshillit të Ministrave në mbi 50 gjykime në Gjykatën Kushtetuese të cilat kanë pasur si objekt shqyrtimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën të akteve të ndryshme normative. Gjithashtu, rezultoi se kandidatja në pozicionin e punës si Kryeinspektore ka menaxhuar një punë voluminoze në realizimin e dy vlerësimeve rradhazi të gjyqtarëve brenda një kohe të shkurtër dhe një numër të konsiderueshëm procedimesh disiplinore.

38. Nga ana tjetër, nga dokumentacioni i administruar rezultoi se kandidatja Marsida Xhaferllari, në cilësinë e autores apo bashkëautore, ka përgatitur 13 publikime profesionale dhe kërkime shkencore, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, të cilat janë të fokusuar kryesisht në fushën e të drejtës penale, të drejtës administrative, drejtësisë kushtetuese, lirive themelore dhe të drejtave të njeriut, etj, sikurse tregohen më poshtë:

- Titulli i publikimit/Kërkimit shkencor: Studim në gjuhën angleze për të miturit në konflikt me ligjin që nuk e kanë mbushur moshën për përgjegjësinë penale; Bashkëautore dhe drejtuese e grupit; publikues “Terres des Homme”; viti i botimit 2019;
- Titulli i publikimit/Kërkimit shkencor: Komentari elektronik për Ligjin për Statusin (Hetimet disiplinore) dhe Ligjin për Qeverisjen; Bashkëautore dhe anëtare e Këshillit Shkencor; botuesi Misioni Euralius; Koha e botimit: 2017 – 2018;
- Titulli i publikimit/Kërkimit shkencor: Manual për Hetimet Disiplinore ndaj Gjyqtarëve dhe Prokurorëve; koha e botimit 2017; Publikim Online i Misionit Euralius, me financim të BE-së;
- Titulli i publikimit/Kërkimit shkencor: Manual i Akteve Procedurale për Gjykimet Administrative, 2016, Publikim Online i Prezencës së OSBE-së; Bashkëautore; publikuesi prezenca e OSBE-së Tiranë; koha e botimit 2016;
- Titulli i publikimit/Kërkimit shkencor: Manual për Drejtësinë Administrative; botim i Prezencës së OSBE-së Tiranë, Autore; Koha e botimit: 2013 dhe 2014;
- Titulli i publikimit/Kërkimit shkencor: Modul trajnimi për gjyqtarët e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës *e-learning* mbi alternativat e burgimit si zgjidhje për

- mbipopullimin në burgje në kuadër të Programit të Këshillit të Evropës për Edukimin e të Drejtave të Njeriut për Profesionet Ligjore (Programi HELP); autore e Kapitullit Mbi të Drejtat Procedurale, në gjuhën angleze; publikues Programi i Këshillit të Evropës për Edukimin e të Drejtave të Njeriut për Profesionet Ligjore (Programi HELP); koha e botimit 2012;
- Titulli i publikimit/Kërkimit shkencor: Manual për Procedurat e Verifikimit të Ankesave dhe të Inspektimit të Gjykatave të Shkallës së Parë dhe të Gjykatave të Apelit; bashkëautore; publikues Misioni Euralius; koha e botimit 2012;
 - Titulli i publikimit/Kërkimit shkencor: “Ligje me shumicë”; autore; publikuese Qendra List; koha e botimit: 2011;
 - Titulli i publikimit/Kërkimit shkencor: Manual i Hartimit të Ligjeve, Një Udhërrëfyes për Procesin Legjislativ në Shqipëri, 2010; botim i dytë i rishikuar i Ministrisë së Drejtësisë dhe Misionit Euralius, me financimin e BE-së; kontribuese kryesore; koha e botimit : 2010;
 - Titulli i publikimit/Kërkimit shkencor: Manual për Aplikimin e Alternativave të Dënimit me Burgim; koha e botimit 2008; botim i Prezencës së OSBE-së;
 - “Strategji për të përmirësuar performancën gjyqësore dhe për të rritur besimin publik tek gjyqësori”, Simpozium mbi Etikën Gjyqësore;
 - “Albanian system of the judicial power inspection”, Maj 2012; Konferencë e Këshillit të Përgjithshëm të Magjistraturës, Romë, 4 – 5 Qershor 2012;
 - “Country Review Report of Bulgaria”, raportuese për Shqipërinë edhe kandidatja Marsida Xhaferllari, Organizata e Kombeve të Bashkuara;

39. Mbështetur në këto të dhëna të rezultateve në ushtrimin e detyrës, si dhe në tematikën e përmbajtjen e produkteve profesionale të lidhura me ushtrimin e detyrës apo edhe me ushtrimin e profesionit, Këshilli vlerëson se në aspektin sasior kandidatja Marsida Xhaferllari ka tregues të lartë angazhimi profesional, i cili rezulton të jetë dukshëm përtej asaj që mund të gjykohet si një angazhim i zakonshëm apo “mesatar” në ushtrimin e profesionit. Për këto arsye, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidaten Marsida Xhaferllari për këtë kriter ligjor vlerësimi me **5 (pesë) Pikë**.

40. Për sa i përket vlerësimit cilësor, Këshilli shqyrtoi të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidatja Marsida Xhaferllari, veçanërisht pesë prej dokumenteve të përzgjedhura prej saj, me synimin për të evidentuar cilësinë, bazuar në tregues shkencorë, elementë që dëshmojnë arritjen e rezultateve profesionale, shkallën e këtyre arritjeve, përfshirë elementë që dëshmojnë spikatjen dhe dallueshmërinë e saj në kuptimin dhe qëllimin për të cilin Kushtetuta dhe ligji e përcakton si kusht për vlerësimin e kandidaturës për këtë Këshill dhe, më tej, për përzgjedhjen e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese nga organet e emërtesës.

41. Në veprimet përgatitore të kryera gjatë procedurave të verifikimit të kandidaturës, në datën 06.08.2019, kandidatja Marsida Xhaferllari ka njoftuar Këshillin me shkrim se për qëllimet e procedurës së vlerësimit në kuadër të pikëzimit për “*Kualifikimin e Përgjithshëm Profesional*” dhe “*Kualifikimin Shtesë Profesional*”, ka përzgjedhur pesë dokumentet profesionale si më poshtë:

- a) Raport datë 12.12.2017 “Mbi inspektimin tematik të veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarit Ergys Selmani të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier”;
- b) Rekomandime Mars 2012 të Ministrisë së Drejtësisë në emër të Këshillit të Ministrave “Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2012”;
- c) Mbrojtjen e Këshillit të Ministrave në gjykimin kushtetues të përfunduar me vendimin nr. 25, datë 08.05.2012, të Gjykatës Kushtetuese me objekt “Shpallja si të papajtueshme

me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të neneve 3, 5, 6, 8 të ligjit nr. 10449, datë 14.07.2011 “Për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të kompleksit të ri parlamentar të Kuvendit të Shqipërisë”;

- ç) Mbrojtjen e Këshillit të Ministrave në gjykimin kushtetues të përfunduar me vendimin nr. 2, datë 18.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese, me objekt “Shfuqizimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 5, datë 10.11.2010 të Këshillit të Ministrave për pensionet suplementare të ushtarakëve”;
- d) Mbrojtjen e Këshillit të Ministrave në gjykimin kushtetues të përfunduar me vendimin nr. 1, datë 06.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese, me objekt “Shfuqizimin e aktit normativ nr. 3, datë 01.08.2012 të Këshillit të Ministrave për lirin e banesave të pronarëve të ligjshëm”.

42. Në lidhje me tërësinë e dokumenteve profesionale të paraqitura nga kandidatja Marsida Xhaferllari dhe, në veçanti, lidhur me pesë dokumentet profesionale të sipërcituara, për realizimin e vlerësimit profesional dhe të pikëzimit përkatës për këtë kriter ligjor vlerësimi, Këshilli shqyrtoi dhe bisedoi në mënyrë të posaçme dhe të kujdesshme përmbajtjen e tyre, duke u mbështetur mbi indikatorë shkencorë, sikurse janë edhe ato të përmendura në Shtojcën nr. 1 të vendimit sipas vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe orientime që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

43. Dokumentet profesionale të shqyrtuara trajtojnë tematika të ndryshme të fushës së të drejtës publike dhe administrative, penale si dhe aspekte të veprimtarisë gjyqësore dhe statusit të gjyqtarit. Këto punime orientohen me fokus kryesor në aspekte të ndryshme të gjykimit kushtetues, shtrirjes dhe thellësisë së tij, njohjes dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe aspekte të së drejtës penale dhe garancive në procesin penal, garancive themelore për funksionimin e një gjyqësori të pavarur, të paanshëm, eficient dhe llogaridhënës, procesit të rregullt ligjor, etj..

44. Njëri ndër indikatorët vlerësues të dokumenteve profesionale është “*Originaliteti dhe/ose impakti (duke përfshirë kontrollin për plagjiaturë) të dokumentit*”. Nisur nga profilet profesionale të kandidatës Marsida Xhaferllari, përmbajtja e dokumenteve të analizuara, tematikës dhe dobisë së përdorimit të tyre nga profesionistë të fushës por edhe nga grupe interesi dhe publiku i gjerë, Këshilli vëren se dokumentet profesionale të shqyrtuara, sikurse edhe në rastin e një numri publikimesh shkencore dhe artikujsh profesionalë, dëshmojnë qasje profesionale origjinale dhe të thelluara të çështjeve ligjore të përzgjedhura për trajtim, për të cilat jo vetëm në kohën e publikimit por edhe aktualisht ka një interes të veçantë për njohje dhe zbatim. Për rrjedhojë, krahas origjinalitetit në përzgjedhjen e tematikave dhe trajtimin e tyre duke sjellë argumente dhe përfundime me interes, vërehet edhe dobishmëria dhe impakti pozitiv i këtyre punimeve në organizimin dhe funksionimin e hallkave të ndryshme të sistemit të drejtësisë, praktikën gjyqësore, në zhvillimin e debatit profesional e doktrinal, si edhe njohjen e të drejtave nga publiku më i gjerë, përfshirë edhe për qëllimet praktike të përdorimit të ligjit në rastet kur mund të pretendojnë njohjen apo kërkojnë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore.

45. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin “*Originaliteti dhe/ose impakti (duke përfshirë kontrollin për plagjiaturë) të dokumentit*”, Këshilli e vlerëson kandidaten Marsida Xhaferllari me **5.857 (pesë pikë tetëqind e pesëdhjetë e shtatë) Pikë**.

46. Për sa i përket treguesit vlerësues të lidhur me “*Aftësitë analitike*”, Këshilli vëren se posaçërisht pesë dokumentet profesionale të shqyrtuara, sikurse edhe në rastin e një numri publikimesh shkencore dhe artikujsh profesionalë, kandidatja Marsida Xhaferllari tregon zotërimin e aftësive të dallueshme për të analizuar informacione dhe për të identifikuar, arsyetuar dhe zbatuar saktë konceptet ligjore, parimet dhe institutet e së drejtës, dispozitat e së drejtës pozitive në trajtimin e çështjeve dhe problematikave që përbëjnë tematikën e punimeve dhe dokumenteve, sipas natyrës dhe qëllimit të vetë këtyre punimeve.

47. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin “*Aftësitë analitike*”, Këshilli e vlerëson kandidaten Marsida Xhaferllari me **5.857 (pesë pikë tetëqind e pesëdhjetë e shtatë) Pikë.**

48. Në lidhje me treguesin vlerësues “*Aftësitë kërkimore*”, Këshilli shqyrtoi veçanërisht pesë dokumentet profesionale të përzgjedhura nga kandidatja Marsida Xhaferllari, sikurse edhe publikime shkencore dhe artikujt profesionalë të paraqitur në dosjen e kandidates. Nga ky shqyrtim, Këshilli vëren se këto punime përmbajnë informacione të larmishme profesionale të përdorura dhe të lidhura efektivisht me natyrën, qëllimin dhe përmbajtjen e secilit prej punimeve të shqyrtuara, të nxjerra nga burime të ndryshme të doktrinës dhe praktikës gjyqësore vendase, si edhe prej atyre të shteteve të ndryshme dhe të institucioneve e gjykatave ndërkombëtare.

49. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin “*Aftësitë kërkimore*”, Këshilli e vlerëson kandidaten Marsida Xhaferllari me **4 (katër) Pikë.**

50. Sipas treguesit “*Saktësia dhe precizoni*”, në thelb, verifikohet nëse në veprimtarinë e tyre profesionale, kandidatët kanë mbuluar me profesionalizëm tematikën e përzgjedhur dhe materiali ka shmangur përsëritjet apo citimet e panevojshme etj. Nga shqyrtimi i dokumenteve profesionale të përzgjedhura nga kandidatja Marsida Xhaferllari, sikurse edhe publikimeve shkencore dhe artikujve profesionalë të paraqitur në dosjen e kandidates, Këshilli vëren se këto punime tregojnë nivel shumë të lartë të përcaktimit të tematikës dhe problemeve juridike për analizë dhe zgjidhje efektive, përdorim të pasur dhe korrekt të terminologjisë juridike dhe strukturim e përdorim në mënyrën dhe vendin e duhur të gjetjeve nga legjislacioni, doktrina, si edhe praktika gjyqësore shqiptare dhe e huaj.

51. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin “*Saktësia dhe precizoni*”, Këshilli e vlerëson kandidaten Marsida Xhaferllari me **4.857 (katër pikë tetëqind e pesëdhjetë e shtatë) Pikë.**

52. Në lidhje me treguesin vlerësues “*Qartësia*”, Këshilli shqyrtoi pesë dokumentet profesionale të përzgjedhura nga kandidatja Marsida Xhaferllari, sikurse edhe publikime shkencore dhe artikujt profesionalë të paraqitur në dosjen e kandidates. Këshilli vlerëson se në këto punime janë të organizuara dhe strukturuar në mënyrë të saktë, gjuha e përdorur është e pasur edhe korrekte, e thjeshtë dhe e kuptueshme. Pasuria, qartësia e gjuhës së përdorur dhe organizimi i duhur i materialit i bëjnë këto punime të kuptueshme dhe të lexueshme, sipas natyrës së punimit dhe grupeve të interesit të cilave synon ti drejtohet.

53. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin “*Qartësia*”, Këshilli e vlerëson kandidaten Marsida Xhaferllari me **4 (katër) Pikë.**

54. Pas shqyrtimit dhe analizës se pesë indikatorëve të mësipërm që përbëjnë vlerësimin cilësor të dokumentacionit profesional të paraqitur, nga kandidatja, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidaten Marsida Xhaferllari me **24.714 (njëzet e katër pikë shtatëqind e katërmëdhjetë) Pikë.**

A. Meritat profesionale – Kualifikimi Shtesë Profesional

55. Në shkronjën “b” të pikës 2 dhe shkronjën “b” të pikës 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, në lidhje me kualifikimin e shtesë profesional, përcaktohen si kritere vlerësimi që kandidatët të kenë veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut dhe në sfera të tjera të së drejtës, vlerësim të dallueshëm të rëndësisë së punimeve akademike, studimeve shkencore, shkrimeve dhe ligjëratave profesionale, botimeve, si dhe pjesëmarrjen në aktivitete shkencore, përvojë të veçantë në një fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese a Gjykatës së Lartë, si edhe pjesëmarrje të dallueshme në procesin e hartimit ose të konsultimit të legjislationit dhe çdo angazhim tjetër profesional të kandidatit përgjatë 5 viteve të fundit në fushën e së drejtës.

56. Prandaj, në zbatim të ligjit, në varësi edhe të profileve dhe karrierave profesionale të secilit kandidat, nga totali prej 12 pikësh për këtë kategori vlerësimi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson deri në 8 pikë ekspertizën në të drejtën kushtetuese dhe në të drejtat e njeriut ose ekspertizën në fusha të tjera të veçanta të së drejtës. Gjithashtu, Këshilli vlerëson deri në 4 pikë angazhimet profesionale shtesë të kandidatëve. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij Këshilli mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara me vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituar sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

57. Në rastin e kandidatës Marsida Xhaferllari, krahas jetëshkrimit, intervistës dhe motivimit për kandidim, Këshilli shqyrtoi dokumentet profesionale dhe të dhënat që mund të disponoheshin nga veprimtaria e saj profesionale si Drejtore e Përgjithshme e Kodifikimit, Drejtore e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë dhe Kryeinspektore në KLD, si edhe nga kontributet e tjera profesionale të kësaj kandidateje në veprimtari të ndryshme, përfshirë publikime apo punime e artikuj shkencorë, pjesëmarrjet në veprimtari shkencore dhe veprimtari të tjera profesionale të lidhura me fushat e së drejtës.

Specializimi në të drejtën kushtetuese, të drejtat e njeriut ose në fusha të tjera të së drejtës

58. Për sa i përket kriterit të parë vlerësues, *ekspertizës në të drejtën kushtetuese dhe në të drejtat e njeriut ose ekspertizës në fusha të tjera të veçanta të së drejtës*, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista dhe dokumente të tjera zyrtare mbi rezultate të vlerësimit profesional etj., si edhe nga shqyrtimi i dokumenteve profesionale të paraqitura nga kandidatja Marsida Xhaferllari, Këshillit i rezulton se historiku dhe karriera profesionale e kësaj kandidateje është i fokusuar në pjesën më të madhe të kohëzgjatjes dhe shtrirjes së saj në fushën e së drejtës publike, në funksione dhe angazhime profesionale të lidhura me çështje të përgatitjes dhe të zbatimit të legjislationit të lidhur me organizimin dhe funksionimin e sistemis gjyqësor dhe atij të drejtësisë në tërësi, sikurse edhe në fusha të tjera të së drejtës si penale, administrative, aspekte të ndryshme të respektimit të lirive themelore dhe të drejtave të njeriut etj..

59. Këshilli vjen në këtë përfundim jo vetëm nga fakti që veprimtaria profesionale e kësaj kandidateje është e lidhur edhe me sistemin gjyqësor si gjyqtare për mbi 8 vite, por edhe me ushtrimin e detyrave profesionale pranë Ministrisë së Drejtësisë për mbi 4 vite (Drejtores e Përgjithshme e Kodifikimit, si dhe Drejtores e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë) si dhe për më shumë se 5 vite si Kryeinspektore e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, përvojë, e cila, e lidhur edhe me interesin e dëshmuar vetjak profesional, ka ndikuar në formimin profesional dhe specializimin e kësaj kandidate në fusha të ndryshme të së drejtës, përfshirë atë kushtetuese dhe të drejtave të njeriut.

60. Nga ana tjetër, Këshilli vëren edhe se në formimin profesional, specializimin dhe ekspertizën e posaçme profesionale të fituar kandidatja Marsida Xhaferllari, një rol të veçantë ka edhe interesi i treguar për ushtrimin e vazhdueshëm të veprimtarive të tjera profesionale me kohë të pjesshme si eksperte ligjore në disa projekte dhe grupe pune përfshirë dhe ndryshimet kushtetuese dhe ligjore në kuadër të Reformës në Drejtësi gjatë dhe pas vitit 2016 (si pjesë e grupit të ekspertëve të nivelit të lartë), eksperte dhe lehtësuese në disa trajnime pranë Shkollës së Magjistraturës, lektore e jashtme për lëndën "Të drejtat e njeriut" në disa universitete jo-publike.

61. Së fundi, si rrjedhojë dhe reflektim i përgatitjes profesionale dhe përvojës së fituar në ushtrimin e detyrave profesionale, në cilësinë e autores dhe bashkëautore, kandidatja Marsida Xhaferllari ka realizuar edhe një numër të madh punimesh shkencore dhe artikujsh profesionale, të botuara brenda dhe jashtë vendit, të cilat, në pjesën më të madhe të tyre, trajtojnë çështjet të organizimit dhe funksionimit të sistemit gjyqësor dhe parimeve kushtetuese mbi të cilat duhet të funksionojë ky sistem, si dhe aspekte të së drejtës penale, administrative etj., që janë të lidhura edhe me njohjen, respektimin dhe mbrojtjen e drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

62. Nisur nga kjo veprimtari profesionale, Këshilli vlerëson se kandidatja Marsida Xhaferllari dëshmon jo vetëm formimin e saj të plotë juridiko-profesional, por edhe se ka arritur një nivel të spikatur dhe të dallueshëm, jo vetëm teorik por edhe të zbatimit e të ndikimit efektiv në praktikë, të specializimit dhe ekspertizës ligjore të thelluar në fushën e të drejtës kushtetuese dhe të lirive themelore e të drejtave të njeriut.

63. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të "*ekspertizës në të drejtën kushtetuese dhe në të drejtat e njeriut*" Këshilli vlerëson ti caktojë kandidates Marsida Xhaferllari **8 (tetë) Pikë**.

Angazhime profesionale shtesë

64. Për sa i përket kriterit të dytë vlerësues, *angazhimeve profesionale shtesë*, sipas të dhënave që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista dhe dokumentet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidates Marsida Xhaferllari, rezulton që për periudhën nga viti 2009 e në vijim, në lidhje ose për shkak të funksioneve që ka ushtruar, kjo kandidate ka marrë pjesë në mbi 50 përfaqësime të Këshillit të Ministrave në Gjykatën Kushtetuese, si edhe ka qenë pjesëmarrëse Komisionin e Licensimit të Ndermjetësve, Komisionin e Mbrojtjes së konsumatorëve, Këshillin Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, Komisionin e Vlerësimit të Provimit të pranimit në Avokati, në Bordin Drejtues të Institutit të Sigurimeve Shoqërore si dhe në Komisionin e Etikës në Konferencën Gjyqësore Kombëtare.

65. Gjithashtu kandidatja Marsida Xhaferllari rezulton se ka përgatitur si autore apo bashkëautore 13 publikime profesionale dhe kërkime shkencore, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, të cilat janë të fokusuar në fushën e të drejtës penale, të drejtës administrative, por edhe të drejtësisë kushtetuese, lirive themelore dhe të drejtave të njeriut. Kjo kandidate ka

qenë pjesëmarrëse si eksperte në projekte të ndryshme me fokus çështje të fushave të ndryshme të së drejtës të organizuara nga institucione të tilla si ENCJ (Rrjeti Europian i Keshillave për Gjyqësorin), Programi i HELP, Council of Europe; EURALIUS, OSBE, etj. Së fundi, rezultoi e angazhuar edhe në grupe pune me kontribute konkrete në procese legislative për hartimin e legjislacionit të organizuara nga Kuvendi, përfshirë edhe ato të Reformës në Drejtësi të finalizuar me ndryshimet kushtetuese dhe legjislacionin e ri të organeve të sistemit të drejtësisë.

66. Këto angazhime shtesë profesionale janë të lidhura me kontribute dhe pjesëmarrje në përgatitjen e analizave dhe studimeve mbi çështje të ndryshme të të drejtave të njeriut, të organizmit dhe mirëfunksionimit të institucioneve të rëndësishme të sistemit gjyqësor apo administrates publike, aksesit në drejtësi, të drejtës penale etj..

67. Prandaj, duke pasur parasysh këto angazhime shtesë profesionale, të shtrira në kohë dhe me kontribute konkrete profesionale në disa fusha të rëndësishme të së drejtës, Këshilli vlerëson që për kriterin vlerësues të *“angazhimeve profesionale shtesë”*, ti caktojë kandidatës Marsida Xhaferllari **4 (katër) Pikë**.

Meritat Morale

68. Në shkronjën “c” të pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 si kriter vlerësimi është përcaktuar që kandidatët të jenë vlerësuar për *“integritetin etik e moral”*. Po kështu, në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016 përcaktohen si kriter *“Rezultatet e vlerësimit të etikës së kandidatëve gjatë punës, nëse ka”*, ndërsa në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2 të këtij neni përcaktohen si kritere vlerësimi edhe *“Reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve”* dhe *“cilësitë morale, të tilla si ndershmëria, përpikëria në ushtrimin e detyrave, drejtësia në marrjen e vendimeve, përgjegjshmëria, besueshmëria, paanësia, dinjiteti dhe prirja për të marrë përsipër përgjegjësi”*. Së fundi, në shkronjën “c” parashikohet si kriter vlerësimi edhe *“angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile”*. Në bazë dhe për zbatim të ligjit, lidhur me këto kritere vlerësimi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka nxjerrë vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 ku përcaktohen rregullime më të hollësishme si edhe shpërndarja e pikëve të vlerësimit sipas peshës specifike të këtyre kritereve.

69. Prandaj, në zbatim të ligjit, lidhur me meritat morale, nga totali prej 30 pikësh për të tre komponentët vlerësues, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson deri në 18 pikë *integritetin etik dhe moral*, deri në 10 pikë *reputacionin që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve* dhe deri në 2 pikë *angazhimin e provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile*. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij Këshilli mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara me vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli dhe Shtojcën nr. 1 të tij, si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituar sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

70. Në rastin e kandidatës Marsida Xhaferllari, krahas jetëshkrimit, paraqitjes dhe sjelljes gjatë parashkrimeve në intervistë, motivimit për kandidim dhe historikut të komunikimit të kandidatës me Këshillin gjatë procesit të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturës, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatës, si edhe çdo të dhënë a dokument tjetër të aksesueshëm publikisht nëpërmjet të cilave mund të nxirreshin elementë të dobishëm për qëllimet e verifikimit dhe vlerësimit të meritave morale të kësaj candidateje.

Integriteti etik e moral

71. Për sa i përket kriterit të parë vlerësues, *integritetit etik e moral*, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, platforma e prezantuar, intervista, komunikimi i kandidatës me Këshillin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Këshillit i rezulton se kandidatja Marsida Xhaferllari në veprimtarinë, sjelljen dhe komunikimin e saj tregon përgjegjësi në përmbushjen e detyrave profesionale, si edhe vëmendje, pjekuri dhe respekt në komunikim, duke parashtruar argumentet e saj gjatë intervistës në mënyrë profesionale, me dinjitet, qartësi dhe bindëse.

72. Gjithashtu, nga të dhënat e mundshme në dispozicion, Këshillit nuk i rezulton që kjo kandidatë të jetë e përfshirë në raste të thyerjes së etikës apo sjelljes gjyqësore të parashikuara edhe në Parimet e Bangalores për sjelljen e gjyqtarëve si një nga aktet më të pranuar ndërkombëtarisht.

73. Lidhur me informacionin e agjencive ligjzbatuese, të dërguar sipas përcaktimeve të ligjit nëpërmjet Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) e që i referohet viteve 2001-2002 mbi të dhëna për sjellje të kandidatës që lidhen me integritetin etik e moral të saj, informacione tashmë të deklasifikuara në masën që e kanë vlerësuar organet kompetente që i administrojnë, ashtu sikurse rezultojnë në arsyetimin dhe përfundimet e ndryshme të anëtarëve të Këshillit në vendimin nr. 111 datë 06.08.2019 për lejimin e kandidimit të kandidatës Marsida Xhaferllari, edhe për sa i përket vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatës për këtë komponent, anëtarët e Këshillit kanë mendime dhe qëndrime dukshëm të ndryshme nisur nga këndvështrimi i secilit prej tyre mbi natyrën, funksionet dhe kompetencat e KED, vlerën dhe përdorshmërinë e të dhënave që përcillen nga institucionet e tjera shtetërore e subjektet private, konsiderimin ose jo si “provë” të këtyre të dhënave dhe akteve etj., të gjitha këto edhe për efekt të arsyetimit e të përfundimeve mbi cenimin ose jo të figurës dhe të integritetit moral dhe etik të kandidatës Marsida Xhaferllari.

74. Prandaj, në vlerësimin dhe vendosjen e pikëve për këtë komponent, si rrjedhim i qëndrimeve dukshëm të ndryshme ndërmjet anëtarëve të Këshillit, vlerësimi dhe pikëzimi përfundimtar kolegjal lidhur me këtë kriter për kandidaten Marsida Xhaferllari është **11.714 (njëmbëdhjetë pikë shtatëqind e katërbëdhjetë) Pikë.**

Reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve

75. Për sa i përket kriterit të dytë vlerësues “*reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve*”, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidatës me Këshillin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Këshillit i rezulton se në karrierën e saj kandidatja Marsida Xhaferllari ka ushtruar funksionin e gjyqtarës, si edhe funksione të rëndësishme në administratën publike si Drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë së Kodifikimit dhe Drejtorisë së Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë. Gjithashtu, kandidatja ka mbajtur detyrën e kryesinspektore nga Janari i vitit 2013 deri aktualisht dhe njëkohësisht ka qënë pjesë e grupit të punës për hartimin e ligjeve të reformës në drejtësi, si pjesë e grupit të ekspertëve të nivelit të lartë pranë Komisionit përkatës në Kuvendin e Shqipërisë. Për veprimtarinë e saj si Kryeinspektore e KLD ajo është vlerësuar nga Presidenti i Republikës në vitin 2016 me nota maksimale.

76. Nga ana tjetër, edhe në lidhje me komponentin vlerësues të *reputacionit që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve*, ashtu sikurse në atë të *integritetit etik e moral*, për sa i përket vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatës, anëtarët e Këshillit kanë mendime dhe qëndrime dukshëm të ndryshme nisur nga këndvështrimi i secilit prej tyre mbi natyrën, funksionet dhe kompetencat e KED, vlerën dhe përdorshmërinë e të dhënave që përcillen nga institucionet e tjera shtetërore e subjektet private, konsiderimin ose jo si “provë” të këtyre të dhënave dhe akteve etj., të gjitha këto lidhur me informacionin e agjencive ligjzbatuese, të dërguar sipas përcaktimeve të ligjit nëpërmjet Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) e që i referohet viteve 2001-2002 mbi të dhëna për sjellje të kandidatës të lidhura me ushtrimin e funksionit të gjyqtarës në atë periudhë. Po kështu edhe në lidhje me vlerësimin që i përket reputacionit të kandidatës për shkak të ushtrimit të funksionit të Kryeinspektores së KLD, si edhe kujdesit e korrektësisë në respektimin dhe zbatimin e ligjit për statusin e gjyqtarit përpara dhe pas miratimit të legjislacionit të Reformës në Drejtësi të vitit 2016.

77. Prandaj, edhe në vlerësimin dhe vendosjen e pikëve për këtë komponent, si rrjedhim i qëndrimeve dukshëm të ndryshme ndërmjet anëtarëve të Këshillit, vlerësimi dhe pikëzimi përfundimtar kolegjal lidhur me këtë kriter për kandidaten Marsida Xhaferllari është **6 (gjashtë) Pikë**.

Angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile

78. Për sa i përket kriterit të dytë vlerësues “*angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile*”, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidatës me Këshillin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Këshillit i rezulton se, përgjithësisht, kandidatja Marsida Xhaferllari nuk ka qenë e angazhuar në veprimtari të tjera të përshtatshme jashtë atyre të lidhura me ushtrimin e detyrës ose të profesionit për ndjekje të kauzave të shoqërisë civile.

79. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të “*angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile*” Këshilli vlerëson ti caktojë kandidatës Marsida Xhaferllari **0 (Zero) Pikë**.

Meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale

80. Në nenin 240 të ligjit nr. 115/2016 parashikohen si kritere vlerësimi disa komponentë të lidhura me aftësitë profesionale dhe personale të kandidatëve mbi çështjet e natyrës drejtuese, organizative, të kapacitetit për vendimmarrje, punës në grup, të komunikimit dhe përfaqësimit publik. Kështu, në pikën 3 të këtij neni parashikohen kriteret vlerësuese për kandidatët si më poshtë:

- “a) cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqesin”;
- b) aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore;
- c) aftësitë e komunikimit;
- ç) aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore;
- d) aftësitë e përfaqësimit publik.”

81. Në bazë dhe për zbatim të ligjit, lidhur me këto kritere vlerësimi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka nxjerrë vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 ku përcaktohen rregullime më të hollësishme si edhe shpërndarja e pikëve të vlerësimit sipas peshës specifike të këtyre kritereve.

82. Prandaj, në zbatim të ligjit, lidhur me meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale, nga totali prej 10 pikësh për të pesë komponentët vlerësues të sipërcituar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson deri në 3 pikë *cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqesin* kandidatët, deri në 4 pikë *aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore*, deri në 2 pikë *aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik*, si edhe me 1 pikë për *aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore*. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij, Këshilli mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara me vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli dhe Shtojcën nr. 1 të tij, si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituar sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

83. Në rastin e kandidatës Marsida Xhaferllari, krahas jetëshkrimit, paraqitjes dhe sjelljes gjatë parashtrimeve dhe bisedës në intervistë, përmbajtjes së motivimit për kandidim dhe historikut të komunikimit të kandidatës me Këshillin gjatë procesit të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturës, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatës, si edhe çdo të dhënë a dokument tjetër të aksesueshëm publikisht nëpërmjet të cilave mund të nxirreshin elementë të dobishëm për qëllimet e verifikimit dhe vlerësimit të meritave organizative, drejtuese dhe menaxheriale të kësaj kandidatje.

Cilësia e platformës dhe të vizionit

84. Këshilli shqyrtoi përmbajtjen e dokumentit me shkrim, platformës mbi motivimin e kandidimit dhe vizionit të kandidatës Marsida Xhaferllari lidhur me qasjen dhe qëndrimet e saj mbi rëndësinë dhe aspektet thelbësore të ushtrimit të detyrës së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, mbi sfidat kryesore me të cilat është përballur dhe duhet të përballlet Gjykata Kushtetuese në ushtrimin e përgjegjësve dhe kompetencave që i ngarkon Kushtetuta dhe ligji. Gjithashtu, në vlerësimin e këtij kriteri, Këshilli mban parasysh edhe parashtrimet dhe shpjegimet e dhëna nga kjo kandidatë gjatë intervistës dhe në përgjigje të pyetjeve që iu drejtuan nga anëtarët e Këshillit.

85. Nisur nga dokumenti me shkrim dhe shpjegimet e paraqitura gjatë intervistës, Këshilli vëren se kandidatja Marsida Xhaferllari paraqiti një nivel shumë të lartë dhe të dallueshëm të njohjes dhe përvojës profesionale së saj në lidhje me rolin dhe pritshmëritë për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, si edhe të kësaj Gjykate në mirëfunksionimin e sistemit demokratik, ndarjes dhe balancimit të pushteteve, shtetit ligjor, respektimit të lirive themelore dhe të drejtave të njeriut dhe në tërësi për zhvillimin ekonomik e social të vendit. Gjithashtu, kjo kandidatë parashtrroi me maturi, në mënyrë profesionale e të hollësishme çështje dhe problematika aktuale dhe të së ardhmes me të cilat duhet të përballlet Gjykata Kushtetuese dhe që kanë të bëjnë me thellësinë dhe shpejtësinë në shqyrtimin e çështjeve, me strukturën, organizimin dhe funksionimin e Gjykatës dhe përmirësimin e burimeve njerëzore, me mënyrat efektive të njohjes dhe afrimit të publikut me veprimtarinë e Gjykatës dhe të vendimeve të saj etj.

86. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues "*cilësia e platformës dhe të vizionit të paraqitur*" nga kandidatët Këshilli e vlerëson kandidaten Marsida Xhaferllari me **3 (tre) Pikë**.

Aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore

87. Lidhur me aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi, Këshilli mbështetet pikësisht në të dhënat që lidhen me përvoja konkrete nga karriera e kandidatëve në funksione dhe pozicione të cilat kërkojnë dhe tregojnë marrjen përsipër të përgjegjësisë dhe ushtrimin e vendimmarrjes në ushtrimin e kompetencave dhe përmbushjen e detyrave të ngarkuara. Gjithashtu, në vlerësimin e kandidatëve për këtë komponent vlerësimi, Këshilli mban parasysh se ushtrimi i çdo detyre, funksioni dhe veprimtari profesionale, edhe kur formalisht nuk lidhet drejtpërdrejt me të drejtën/detyrimin për ushtrimin e kompetencës vendimmarrëse, gjithsesi përmban elementë që tregojnë aftësi të provuara ose premtuese për të marrë nisma, për të kërkuar zgjidhje, për të marrë përgjegjësitë si edhe vendimet e duhura e në kohën e duhur sipas përcaktimeve të ligjit dhe në përgjigje të ndjeshmërisë së publikut.

88. Në rastin e kandidatës Marsida Xhaferllari, krahas jetëshkrimit, parashtrimeve dhe bisedës në intervistë, përmbajtjes së platformës dhe motivimit për kandidim, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, si edhe aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatës, për të evidentuar të dhëna në lidhje me aftësitë e provuara të kësaj kandidateje për të marrë vendime gjatë karrierës së saj profesionale të dëritanishme.

89. Këshilli vëren se kandidatja Marsida Xhaferllari, në karrierën e saj profesionale, ka ushtruar për mbi 8 vite detyrën e gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier duke përballuar ngarkesën e madhe të punës dhe duke u vlerësuar shumë mirë për ushtrimin e detyrës, duke treguar aftësi të dalluara vendimmarrëse. Gjithashtu kjo kandidate nga viti 2008 e në vazhdim ka kryer detyra në nivel të lartë drejtues si Drejtore e Përgjithshme e Kodifikimit, (*Shtator 2008 – Gusht 2011*), Drejtore e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë (*Gusht 2011– Janar 2013*) dhe nga Janari 2013 e në vazhdim si Kryeinspektore e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Këshilli administroi edhe shkresën e datës 11.10.2016 të Presidentit të Republikës, i cili, në cilësinë e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ka vlerësuar punën e Kryeinspektores Marsida Xhaferllari dhe aftësinë e saj në për të përmbushur në cilësi detyrat e ngarkuar nga Ligji dhe vendimet e KLD-së, duke treguar saktësi dhe shpejtësi të kënaqëshme për realizimin e detyrave.

90. Veprimtaria profesionale për periudhën prej rreth 19 vitesh në organet e sistemit të Drejtësisë, shumëllojshmëria e çështjeve të trajtuara, por edhe mendimet dhe zgjidhjet e sugjeruara për tematika të rëndësishme të fushës ligjore në punimet shkencore dhe artikujt e publikuar nga kjo kandidate tregojnë të dhëna premtuese edhe për marrjen e përgjegjësisë dhe nismës për vendimmarrje, të cilat, së bashku me profesionalizimin kanë rëndësi thelbësore për ushtrimin e suksesshëm të detyrës së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

91. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues *“aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore”*, Këshilli e vlerëson kandidaten Marsida Xhaferllari **me 3.571 (tre pikë pesëqind e shtatëdhjetë e një) Pikë.**

Aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik

92. Aftësitë e komunikimit, në të gjitha format, veçanërisht me kolegët dhe palët, sikurse edhe në përfaqësimin publik e me të tretët, të shprehurit në mënyrë të qartë, lehtësisht të kuptueshme, të matur, me respekt dhe në mënyrë jodiskriminuese, luajnë një rol të rëndësishëm në kryerjen e funksionit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

93. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit, mënyra dhe stili i parashtrimeve me shkrim të platformës, sjellja, mënyra e komunikimit dhe argumentimit gjatë bisedës në intervistë, si edhe nga përmbajtja, strukturimi dhe stili i hartimit të dokumenteve profesionale të administruara në dosjen e kandidatës, vlerësimet e dhëna për kandidate më parë nga punëdhënësit, Këshilli vëren se kandidatja Marsida Xhaferllari zotëron aftësi të shumë të mira për të komunikuar me maturi, për të dëgjuar me respekt dhe për tu përgjigjur me profesionalizëm dhe thjeshtësi në lidhje me të gjitha çështjet dhe problematikat që vlerëson të trajtohen, ashtu edhe për çështje dhe problematika që ngrihen nga të tjerët.

94. Gjithashtu, nga materialet me shkrim dhe nga komunikimi e biseda gjatë intervistës, rezulton se kjo kandidate zotëron edhe aftësi të shumë të mira për përfaqësimin publik, pra për të përfaqësuar atë që mendon se është më e drejtë edhe për kolegët, dhe komunitetin në lidhje me një çështje apo kauzë të caktuar. Këshilli administroi dhe shkresën e dt. 11.10.2016 të Presidentit të Republikës i cili në cilësinë e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka vlerësuar punën e Kryeinspektore Marsida Xhaferllari. Sipas këtij vlerësimi ajo shquhet për marrëdhënie shume korrekte bashkëpunimi me kolegët, marrëdhënie të drjta me stafin që ajo drejton, marrëdhënie luajale me eprorët, dallohet për punën në grup. Në këtë shkresë ajo është vlerësuar për përfaqësimin dinjitoz të Inspektoratit, në raport me institucionet e tjera, aftësite organizative, aftësitë shumë të mira komunikuese ndjenjën e përgjegjësisë, si dhe ka integritet të lartë në ushtrimin e detyrës.

95. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të “*Aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik*”, Këshilli e vlerëson kandidaten Marsida Xhaferllari me **2 (dy) Pikë**.

Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore

96. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, për vetë natyrën e këtij funksioni, mënyrës së funksionimit dhe kolegjalitetit të kërkuar në veprimtarinë e vendimmarrjen kësaj Gjykate, duhet të zotërojë aftësitë e duhura për një qasje metodike ndaj punës, si dhe aftësinë për të qenë i përfshirë në punën në grup, me gjyqtarët e tjerë, këshilltarët dhe anëtarët e stafit të Gjykatës. Pjesë e kësaj aftësie është edhe nevoja për t’u përshtatur shpejt me zhvillimet e reja, si edhe ndaj nevojës për tu përfshirë në veprimtari në ambiente multikulturale dhe multidisiplinore gjatë karrierës gjyqësore.

97. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit, sjellja, mënyra e komunikimit dhe argumentimit gjatë bisedës në intervistë, si edhe nga dokumentet profesionale të administruara në dosjen e kandidatës, Këshilli vëren se kandidatja Marsida Xhaferllari zotëron aftësitë e duhura për të punuar në grup, përfshirë atë për të punuar në ambiente multikulturale dhe multidisiplinore. Prezantimi dhe dokumentet profesionale dëshmojnë se kjo kandidate është përfshirë vijësisht në projekte profesionale me kolegë të tjerë, vendas apo të huaj, për realizimin e publikimeve të shumta shkencore dhe artikujve profesionalë.

98. Gjithashtu, ushtrimi për një kohë të gjatë i funksionit të këshilltares ligjore në Gjykatën Kushtetuese, për vetë mënyrën kolegiale dhe punën në grup që kërkohet në këtë Gjykatë për përgatitjen e çështjeve për shqyrtim, bisedimin e zgjidhjes së tyre dhe përgatitjen e vendimeve përkatëse, i kanë mundësuar kësaj kandidateje fitimin e përvojës dhe shprehive të duhura për punën në grup dhe në çështje e situata të larmishme. Zotërimi i këtyre aftësive rezulton i reflektuar edhe në vetë mënyrën e parashtrimit me shkrim të çështjeve në platformën e paraqitur, si edhe në komunikimin e bisedën e zhvilluar me Këshillin gjatë intervistës.

99. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues “Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturale”, Këshilli e vlerëson kandidaten Marsida Xhaferllari me **1(një) Pikë**.

Vlerësimi përfundimtar i kandidates

100. Në përfundim të arsyetimit mbi mënyrën dhe shkallën e vlerësimit për të gjitha kriteret ligjore të parashikuara nga ligji dhe të pikëzimit përkatës të treguar më sipër në këtë Vendim, në funksion të procedurave ligjore të përzgjedhjes së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe për efekt të renditjes së kandidatëve për vendet vakante në të cilat ka kandiduar, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi i rezulton se kandidatja Marsida Xhaferllari vlerësohet në total me **81.999 (tetëdhjetë e një pikë nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) Pikë**.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 125 dhe pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të nenit 7/a, pikës 3 të nenit 7/b dhe pikës 4 të nenit 7/c të ligjit nr. 8577/2000 “ Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 239 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të pikës 67 të të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Vlerësimin e kandidates Marsida Xhaferllari me **81.999 (tetëdhjetë e një pikë nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) Pikë**, në lidhje me kandidimin e saj për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 04.03.2019.
2. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI

Ardian DVORANI



Mendim ndryshe

i anëtarëve Margarita Buhali dhe Fatri Islamaj lidhur me vlerësimin me pikë të kandidatës Marsida Xhaferllari

Ne anetarët e KED **Margarita Buhali dhe Fatri Islamaj** kemi votuar për një vlerësim të ndryshëm të kriterit të meritave morale, konkretisht të integritetit etike moral dhe reputacionit, që gëzon në shoqëri duke I dhënë një vlerësim maksimal në të dy këto komponent. I kemi dhënë vlerësimin me 18 pikë për integritetin etik dhe moral, si dhe me 10 pikë për reputacionin. Për sa I përket vlerësimin të integritetit moral nga tabelat që shoqërojnë votimin e gjithë anëtarëve të KED rezulton se pikët maksimale I janë dhënë nga shumica e anëtarëve të KED, ndërsa te kriteri I reputacionit po ashtu vihet re se vlerësimi I shumicës së anëtarëve është shumë pranë vlerave maksimale. Ndodhur përballë faktit se qëndrimet e disa anëtarëve të KED për pikëzimin lidhur me këto komponentë të metodologjisë së vlerësimin kanë sjellë një ndikim të dukshëm në vlerësimin total me pikë të kësaj kandidate e si rrjedhim në renditjen e saj, në ndryshim me vlerësimin e vecantë dhe total të dhënë nga shumica e anëtarëve të KED për të, ne si anëtar vlerësojmë se duhet të japin mendimin tonë me shkrim për vlerësimin e kriterit të meritave morale për kandidaten Marsida Xhaferllari duke mbajtur në konsideratë këtu parashikimet e nenit 229/3 të ligjit nr.115/2016 ku përcaktohet rregulli ligjor se Këshilli vendos me shumicën e votave . Mbi bazën e këtij rregulli, duke mbajtur në konsideratë dhe pikët, që secili prej anëtarëve të KED I ka dhënë kësaj kandidate paraqesim mendim tonë për vlerësimin maksimal me 28 pikë në kriterin e meritave morale të kandidatës për sa më poshtë;

a-Sipas metodologjisë të miratuar me vendimin nr.51/2019 të KED është përcaktuar se do të mbahet në konsideratë për të vlerësuar integritetin moral të kandidatëve përgjegjshmëria dhe respekti, që kandidatja prezanton në komunikim, sjelljen e performancën e saj. Në intervistën e realizuar me kandidaten nga KED u reflektua një ndjenjë e lartë vetkontrolli dhe përgjegjshmërie në përgjigjen e çdo pyetje, që i është bërë nga KED. Mënyra e prezantimit të saj evidentoi jo vetëm një person profesionist, por edhe me integritet të lartë, që është i gatshëm të marr përsipër çdo lloj detyre për të dhënë kontributin e saj në respektimin e të drejtave të njeriut dhe të parimeve të shtetit të të drejtës duke e parë Gjykatën Kushtetuese si një institucion bazë për të garantuar sigurinë juridike dhe parimin e ndarjes e balancimit të pushteteve. Kandidatja reflektoi autoritet, përgjegjshmëri dhe profesionalizëm të lartë. Prezantimi I saj para KED u karakterizua nga thjeshtësia dhe modestia, pavarësisht shkallës së lartë të profesionalizmit, që dispononte dhe detyrave të rëndësishme shtetërore, që kishte mbajtur gjatë gjithë karrierës së saj. Ky qëndrim tregon se kandidatja mbart vlera të dukshme morale dhe ndershmërie duke respektuar çdo profesionist të fushës pa mbivlerësuar meritat e saj profesionale. Gjithashtu sikurse pranohet në vendimet e vlerësimin të kandidatës së datës 10.09.2019 nuk rezulton që për këtë kandidate të jetë provuar asnjë nga rastet e thyerjes se etikes apo sjelljes gjyqesore te parashikuara edhe ne Parimet e Bangalores per sjelljen e gjyqtareve. Në përputhje me metodologjinë e miratuar në vlerësimin me pikët maksimale të kandidatës në integritetin moral ne kemi mbajtur në konsideratë rrethanat e mësipërme, pasi intervista e kandidatit është një e dhënë e rëndësishme për vlerësimin e besueshmërinë dhe performacës etike të kandidatit.

b- Lidhur me Informacionin e dërguar nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) që i referohet vitit 2002 lidhur me figurën morale të kandidatës shumica e Këshillit, vlerësoi se nuk mund të konsiderohet si provë, që çënon integritetin moral të kandidatës. Kjo mund të verifikohet nga pikët, që i janë dhënë nga shumica e anëtarëve në listën e votimit të anëtarëve. Sipas Metodologjisë së miratuar me vendimin nr.51/2019 të

KED pranohet integriteti i prezumuar i kandidatëve. Ky prezumim mund të rrëzohet vetëm në rastin kur KED disponon prova që vërtetojnë të kundërtën. Në Metodologjinë e vlerësimit të meritave morale është përcaktuar në mënyrë të shprehur se; *Një nga sfidat e mëdha të Këshillit për vlerësimin e meritave morale do të jetë gjetja e burimeve përkatëse dhe përcaktimi i besueshmërisë së tyre. Anëtarët e Këshillit duhet të vërtetojnë informacionin e marrë*. Nisur nga ky përcaktim, KED mund të marrë në konsideratë një informacion kundër figurës morale të kandidatit vetëm kur vërtetohet saktësia e informacionit. Informacioni duhet të reflektojë sjelljen e kandidatit në situata konkrete, të cilat të provohet nëse ai ka prirje për të kryer veprime në kundërshtim me ligjin ose imazhin publik të gjyqtarit.

Parashikimet e sipërcituara të metodologjisë janë në harmoni me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.2/2017. Në pikën 39 të këtij vendimi është parashikuar se; *Gjykata vlerëson se institucionet kushtetuese të rivlerësimit kanë autoritetin për të ruajtur një kontroll të plotë mbi procesin e verifikimit të figurës, si dhe për të pasur akses tek të gjitha materialet përkatëse. Në vlerësimin e saj përdorimi i një grupi të tillë pune sipas nenit 36 të ligjit nuk shfaq probleme kushtetutshmërie nëse ai nuk përbëhet vetëm nga personeli i organeve të sigurisë por përfshin edhe përfaqësues të KPK-së. Sipas nenit 14 të ligjit relatori në çdo rast duhet të ndërmarrë të gjitha procedurat për të siguruar provat e nevojshme për procesin e vendimmarrjes së trupës gjyquese. Po ashtu, sipas nenit 23 të ligjit këshilltarët ligjorë kryejnë edhe detyra të tjera të caktuara nga relatori i çështjes, për rrjedhojë atyre mund t'u caktohet një rol aktiv në veprimtarinë e grupeve të punës, nëpërmjet delegimit. Gjykata, gjithashtu, rritet se përdorimi i kontrolleve për qëllime të procesit të rivlerësimit, sipas dispozitave të kreut V të ligjit, duhet të jetë nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e KPK-së dhe duhet t'i nënshtrohet kontrollit të KA-së*. Nisur nga ky përcaktim dhe parashikimet e nenit 282 të ligjit nr.115/2016 rezulton se informacionet lidhur me pastërtinë e figurës duhet të jenë për raste dhe të shoqërohen me prova, të cilat duhet ti nënshtrohen kontrollit nga organet kompetente. KED si një organ kushtetues për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të gjykatës kushtetuese, që i dorëzohen organeve të emërtesës verifikon mbi të njëjtat standarte figurën e kandidatëve jurist, gjë që del nga parashikimet e nenit 282 të ligjit nr.115/2016, duke bërë të detyrueshme verifikimin e provave lidhur me cdo informacion të ardhur nga organet ligjzbatuese, që ka të bëjë me figurën morale të kandidatit. Vetëm në këtë mënyrë do të zbatohet i njëjti standat për vlerësimin e meritave morale si për kandidatët për anëtar të gjykatës kushtetuese nga radhët e juristëve dhe për ata nga radhët e magistratëve, që i janë nënshtrohet procesit të rivlerësimit. Në të kundërt do të kishin një trajtim të pabarabartë të shtetasve para ligjit, konkretisht në drejtim të vlerësimit të meritave të tyre morale, pasi për kandidatët jurist informacionet e përcjella nga DSIK do të merreshin të mirëqëna, ndërsa për kandidatët magistrat këto informacione do i nënshtroheshin procesit të të provuarit. Verifikimi i provueshmërisë së cdo informacioni të ardhur duhet të mbahet në konsideratë në vlerësimin e meritave morale të kandidatëve për të shmangur standartet dyfishe të vlerësimit të kriterit moral dhe dyshimet për qëndrime të pabazuara. Nisur nga këto kritere, informacioni i paverifikuar i DSIK nuk mund të bëhet shkak për penalizim të kandidatit në vlerësimin e meritave morale, pasi morali prezumohet dhe prezumimet rrëzohen vetëm me prova.

Në rastin konkret informacioni i dërguar nga DSIK për figurën morale të kandidatës nuk u vërtetua, pavarësisht përpjekjeve të bëra nga KED për sigurimin e të dhënave konkrete, me të cilat kishte të bënte ky informacion. Ky fakt është i pranuar nga KED në vendimin për lejimin e kandidimit të kandidatës, ku është analizuar se përse KED nuk ka marrë në konsideratë informacionin e dërguar nga DSIK. Konkretisht në pikën 80 të vendimit nr.111 dt.06.08.2019 KED ka arsyetuar se; *Duke mbajtur në konsideratë të gjitha aktet e administruara në kuadër të procesit të verifikimit të figurës së kandidatës në kuptim të nenit 86 e 87 të vendimit nr.4 dt.11.03.2019, **KED vlerëson se informacioni i përcjellë nga DSIK me shkresat Nr.5878 prot, të datës 25.06.2019 dhe nr.7164 datë 01.08.2019, në gjëndjen***

që paraqitet, nuk provon ekzistencën e rrethanave skualifikuese nga kandidimi. Gjithashtu KED mban parasysh dhe faktin se në mungesë të të dhënave konkrete kundër pastërtisë së figurës së kandidates, kohës së largët konkretisht vitit 2002 që referon informacioni, pra më shumë se 10 vjet më parë se periudha e verifikimit të pastërtisë së figurës (sipas nenit Dh të Kushtetutës dhe ligjit nr.84/2016, detyrimin e KED për respektimin e të njëjtit standart kontrolli të informacioneve mbi pastërtinë e figurës si për magjistratët dhe juristët në kuptim të vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetute dhe praktikës së KPK në raste të ngjashme, konfirmimit zyrtar nga prokuroria se kandidatja sipas nenit 236 të ligjit nr.115/2016, kandidatja nuk ka qënë asnjëherë në procedim penal, KED vlerëson se nuk ka shkaqe për ndalimin e kandidimit të saj në postin vakant të gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese.

Nga sa mësipër rezulton se KED ka shprehur qëndrimin se nuk e vlerëson si provë informacionin e DSIK të dërguar me shkresat Nr.5878 prot, të datës 25.06.2019 dhe nr.7164 datë 01.08.2019. Nën këtë llogjikë, kemi mbajtur të njëjtin standart vlerësimi për këto informacione sikurse rezulton edhe në vendimin e lejimit të kandidimit. I njëjti informacion nuk mund të vlerësohet me fuqi të ndryshme provuese në dy vendime të KED, që kanë lidhje me të njëjtën kandidatë. Fakti se ky informacion nuk është marrë në konsideratë në vendimin e lejimit të kandidimit, atëherë ai nuk mund të merrej në konsideratë si provë as për vlerësimin e kriterit të integritetit moral të kandidates në përputhje me parimin e sigurisë juridike. Qëndrimi i kundërt për vlerësimin e të njëjtit informacion ndryshe do të ndikonte në procesin e pikëzimit të kriterit të meritave morale për kandidatin. Pikërisht në respektim të parimit të sigurisë juridike për vendimet e marra paraprakisht dhe qëndrimit uniformë për vlerësimin e informacioneve të pashoqëruara nga provat, ne anëtarët M.Buhali dhe F.Islamaj, sëbashku me anëtar të tjerë të KED sipas listës së pikëzimit, kemi vlerësuar se kandidatja duhet të merrte pikët maksimale në kriterin e integritetit moral prej 18 pikësh.

Qëndrimi i KED i mbajtur në vendimin nr.111, datë 06.08.2019 për lejimin e kandidimit të kandidates provon se nuk ka të dhëna që çënojnë integritetin moral të saj. Si rrjedhim për aq kohë sa nuk provohet e kundërta, vlerësimi i meritave morale duhet të bëhet në favor të kandidates dhe prezumimit të parashikuar në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

c-Nga provat e siguruar gjatë procesit të verifikimit dhe vlerësimit të kandidates M.Xhaferllari u provua se për pesë raste të tjera, duke përfshirë këtu edhe raportin para KPK në procesin e vetingut të kandidates sipas raportit 01.02.2019, figura morale e kandidatit i ishte nënshtruar kontrolleve nga organet ligjzbatuese duke u konsideruar një figurë e pastër dhe e përshtatshme për vijimin e detyrës. Nga kandidatja në shpjegimet e dhëna i është bërë e ditur KED se figura e saj është verifikuar në vitin 2009 dy herë dhe ka përfutur çertifikatën e sigurisë “C Tepër Sekret” dhe “NATO Secret”; në vitin 2012 për marrjen e çertifikatës së sigurisë “C Tepër Sekret”; në vitin 2015 dhe ka përfutur çertifikatën e sigurisë “C Tepër Sekret”; në vitet 2017 – 2019. Ajo i ka shoqëruar shpjegimet e saj me aktet përkatëse. Këto të dhëna për pastërtinë e figurës së kandidates të rezultuara ndër vite nga institucionet ligjzbatuese duhet të merreshin në konsideratë për të vlerësuar integritetin moral të kandidates. Duke qënë se informacioni i drejtuar KED nga DSIK me shkresën Nr.5878 prot, të datës 25.06.2019 ishte i vetmi informacion që ngrinte dyshime për figurën morale të kandidates, në ndryshim me 5 aktet e tjera, ky informacion jo vetëm nuk mund të mbivlerësohej në raport me aktet e tjera dhe as nuk mund të merrej i mirëqënë, kur nuk ishte i shoqëruar me prova dhe nuk referonte rrethanat konkrete ku bazohej.

d-Në vijim të vlerësimit të integritetit moral të kandidates, ne anëtarët e KED, M.Buhali dhe F.Islamaj çmojmë se kandidatja gjatë gjithë karrierës së saj ka mbajtur poste të rëndësishme me detyra drejtuese e vendimmarrëse duke përballuar një ngarkesë të lartë pune. Në cdo institucion, që ajo ka punuar ka reflektuar ndjenjë të lartë përgjegjësie për detyrës, aftësi profesionale, korrektësi, angazhim në plotësimin në kohë të detyrës, bashkëpunim si me vartësit ashtu edhe ndërinstytucional duke u vlerësuar për performancën e saj nga punëdhënësi.

e- Lidhur me kriterin e dyte vlerësues të meritave morale konkretisht “reputacionin që gëzon kandidatja në shoqëri e midis kolegëve” rezulton se kandidatja është një figurë e njohur në gjithë radhët e juristëve dhe gjyqtarëve për profesionalizmin e saj të spikatur, autoritetin dhe ndjenjën e lartë të përgjegjësive që e karakterizon në realizimin shpejt dhe me përkushtim të detyrave. Kontributi i saj i drejtëpërdrejtë si profesioniste në cdo pozicion pune, ku ka punuar ka lënë gjurme në karrierën e saj dhe te institucioneve ku ka shërbyer. Si rezultat i përkushtimit të saj në punë, ajo është dalluar për përmirësimet, që ka sjellë në përmbushjen e detyrave nga institucioni dhe niveli i lartë përgjegjshmërisë së treguar në formulimin e cdo dokumenti ose akti produkt i punës së saj.

Kandidatja ka mbajtur detyrën e kryeinspektore nga Janari i vitit 2013 deri aktualisht dhe ka qënë pjesë e grupit të punës për hartimin e ligjeve të reformës në drejtësi. Përpjekjet për të realizuar reformën në drejtësi kanë filluar që në vitin 2014 e më pas, pra vetëm pak kohë pasi kandidatja kishte marr postin e kryeinspektore. Si rrjedhim nevoja për të reformuar sistemin e drejtësisë nuk ishte pasojë e veprimtarisë inspektuese të kandidates, pasi ajo sapo ishte emëruar në detyrën e kryeinspektore pikërisht në kohën kur filloi të projektohej reforma në drejtësi, ndërkohë që ky organ sëbashku me Këshillin e lartë të Drejtësisë si organi vendimmarrës për procedimin disiplinor të gjyqtarëve kishte filluar funksionimin nga viti 1998. Nga ana tjetër në raport me të gjithë kryeinspektorët e tjerë rezulton se gjatë periudhës së veprimtarisë së kandidates si kryeinspektore janë realizuar dy vlerësime rradhazi për të pothuajse të gjithë gjyqtarët dhe një numër të konsiderueshëm procedimesh disiplinore. Për punën e saj ajo është vlerësuar nga Presidenti i Republikës në vitin 2016 me nota maksimale. Prandaj reputacioni i saj në radhët e juristëve dhe në institucionet, ku ajo ka punuar ose me institucionet me të cilët ka bashkëpunuar është i njohur, duke u perceptuar si një juriste e spikatur e aftë të përballojë cdo sfidë dhe me përkushtim për të realizuar sa më mirë detyrat që i ngarkohen.

Vendimi i KPK nr.115 dt.11.03.2019 për pushimin e procesit të rivlerësimit të kandidates nuk ndikon në vlerësimin e reputacionit të saj në radhët e kolegëve. KPK vlerësoi se kandidatja e kishte humbur statusin e magjistratit dhe për këtë shkak ajo nuk mund të vlerësohej nga KPK. Megjithëse ky vendim ende nuk ka marr formë të prerë, pasi është ankimuar vetëm nga kandidatja dhe jo nga komisioneri publik, cilësimi i kandidates si juriste dhe jo si magjistrate nuk çënon vlerësimin e reputacionit të saj. Ky i fundit është i lidhur ngushtësisht me perceptimin e publikut për atë që personifikon personi individualisht si rezultat i punës së kryer prej tij dhe jo me titullin, që personi mban konkretisht si jurist apo magjistrat. Për më tepër kandidatja rezulton se ka përfunduar shkollën e magjistraturës me rezultate shumë të mira në vitin 2000 duke u diplomuar si magjistrate-gjyqtare, pavarësisht se më vonë për shkak të angazhimeve të saj profesionale nuk ka ushtruar detyrën e gjyqtarit. Në këto kushte njohuritë e saj profesionale janë të certifikuar nga diploma e shkollës së Magjistraturës e dhe jo vetëm nga një provim i organizuar nga kjo shkollë sipas ligjit nr.84/2016. Prandaj fakti nëse kandidatja ka humbur apo jo statusin e magjistratit, nuk ndikon në reputacionin që ajo gëzon në radhët e publikut për profesionalizmin e saj. Kandidatja iu nënshtrua procesit të verifikimit të kandidimit nga KED si juriste dhe jo si magjistrate. Në vendimin nr.5 dhe atë nr.51/2019 të KED për kriteret e vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve rezulton se nuk

është bërë asnjë diferencim në pikëzim lidhur me vlerësimin e reputacionit për kandidatët jurist apo magjistrat, për anëtar të gjykatës kushtetuese, në përputhje kjo me parashikimet e ligjit nr.115/2016 dhe parimin e trajtimit të barabartë të shtetasve para ligjit.

Për sa mësipër duke konstatuar se me sjelljen dhe veprimtarinë e saj përmbush pritshmëri për marrjen e përgjegjësive ligjore dhe institucionale, si edhe pritshmërinë e publikut për gëzimin e cilëve profesionale e morale për ushtrimin e detyrës së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, në lidhje me kriterin vlerësues të *“reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve”* ne anëtarët F.Islamaj dhe M.Buhali e kemi vlerësuar kandidaten M.Xhaferllari me 10 (dhjetë) pikë.

Për sa mësipër

Bazuar në nenit 229/3, 240 të ligjit nr.115/2016, nenit 125 e 149/d të Kushtetutës

Mendimi ynë për vlerësimin e meritave morale të kandidatës M.Xhaferllari është

- Vlerësimi me 18 (tetëmbëdhjetë) pikë për kriterin e integritetit moral.
- Vlerësimi me 10 (dhjetë) pikë për kriterin e reputacionit

Anëtare
Margarita Buhali



Anëtar/relator
Fatri Islamaj



Mendim
për motivimin e vlerësimit dhe pikëzimit të kandidaturës së kandidatës Marsida Xhaferllari

Në cilësinë e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi vlerësojmë se për sa i përket kategorisë së kriterëve të vlerësimit të përfshirë në “meritat morale”, konkretisht lidhur me integritetin etik dhe moral, si edhe reputacionin që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve, pavarësisht aftësive të vlerësuara profesionale, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga procesi i verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturë, kandidatja Marsida Xhaferllari nuk i përmbush elementët mbi vlerat themelore të gjyqtarit dhe pritshmërinë e publikut mbi integritetin etik e moral dhe reputacionin që duhet të gëzojë personi i cili kandidohet për ushtrimin e funksionit kushtetues të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

Prandaj, në lidhje me të dy këto kritere vlerësuese, kemi vlerësuar dhe pikëzuar këtë kandidate me 0 (zero) Pikë.

Nga të dhënat që përmban dosja e kandidimit, veçanërisht atyre që janë shqyrtuar dhe administruar në procedurën e verifikimit të plotësisht të kushteve ligjore për lejimin e kandidimit, ka rezultuar se:

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me shkresën nr. 352 datë 20.05.2019, nr. 353 datë 20.05.2019 dhe me nr. 408 datë 25.06.2019, ndërmjet të tjerave, i është drejtuar DSIK me kërkesë për ndihmë administrative në procedurën e kerkimit të informacionit të klasifikuar dhe përpunimit profesional të këtij informacioni, nga Shërbimi Informativ i Shtetit dhe Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, për verifikimin e integritetit të të gjithë kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektorin i Lartë të Drejtësisë, si edhe përcjelljen e këtyre informacioneve pranë KED-së.

Informacioni nga agjencitë ligjzbatuese dhe ndihma administrative nga DSIK është kërkuar lidhur me kushtet vijuese ligjore të kandidimit:

- a) Kandidati nuk është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës;
- b) Kandidati nuk ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

Me shkresën “sekret” nr. 5706 datë 24.06.2019 dhe shkresën “sekret” nr. 5878 datë 25.06.2019 (të cilat janë të deklasifikuara plotësisht, sipas kërkesës së KED-së, me vendimin nr. 189 datë 18.07.2019 të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret Shtetëror” pranë DSIK), DSIK parashton në përmbajtje të njëjtë se:

“Në përfundim të procedurave të verifikimit të Znj. Marsida Xhaferllari, kandidate për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektorin i Lartë të Drejtësisë, nga organet kompetente disponohen të dhëna të viteve 2001-2002 ku ngrihen dyshime për përfshirje në veprime korruptive duke favorizuar palën nën hetim kundrejt përfitimit financiar”.

KED, me shkresën nr. 438 datë 25.07.2019 i është drejtuar përsëri DSIK-së me kërkesë për ndihmë administrative për njohjen e mëtejshme të plotë ose me informacion më të zgjeruar në lidhje me të dhënat e klasifikuara mbi të cilat janë mbështetur ato të shkresave sekret të deklasifikura të cituara në paragrafin më sipër, sikurse edhe për mundësinë e deklasifikimit të këtyre informacioneve shtesë të klasifikuara që vlerësohet të dërgohen pranë KED nga organet ligjzbatuese.

Në përgjigje të kësaj kërkesë të KED-së, me shkresën “sekret” nr. 7164 datë 01.08.2019 (e cila është deklasifikuar pjesërisht, sipas kërkesës së KED, me vendimin nr. 209 datë 02.08.2019 të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret Shtetëror” pranë DSIK), DSIK parashtron se :

“Në përfundim të procedurave të verifikimit të Znj. Marsida Xhaferllari, kandidate për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, nga organet kompetente disponohen të dhëna të viteve 2001-2002 ku ngrihen dyshime për përfshirje në veprime korruptive duke favorizuar palën nën hetim kundrejt përfitimit financiar”.

Sa sipër.

Për Zj. Marsida Xhaferllari është ndarë informacion me institucionet shtetërore (I), konkretisht:

1. Informacionme lëndë “Mbi veprime abuzive dhe korruptive të kryera ngaku përmendet dhe Zj. Marsida Xhaferllari”.
2. Informacion me lëndë “Mbi veprime abuzive të Zj. Marsida Xhaferllaripër mitmarrje duke favorizuar palët nën hetim”.
3. Informacion me lëndë “Mbi veprime abuzive dhe korruptive të Zj. Marsida Xhaferllari”.

(I) Kur organi kompetent krijon bindjen për një shkelje të ligjit, informon institucionet përkatëse, duke mbrojtur burimet dhe metodat informative“

Me vendimin nr. 111 datë 06.08.2019, pavarësisht nga informacionet e sipërcituara të përcjella nga ana e DSIK, mbi të dhëna në ngarkim të kandidates Marsida Xhaferllari si e përfshirë në veprime abuzive e korruptive, madje për të favorizuar palët në hetim, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka disponuar për lejimin e kandidimit, ndërmjet të tjerave me motivin se këtij Këshilli nuk i janë përcjellë të dhëna të mëtejshme më konkrete për natyrën e veprimeve dhe kontakteve të kandidates, as të dhëna më konkrete për të ardhur në përfundimin nëse “palët” apo personat e kontaktuar prej saj përfshihen në kategorinë “Person i përfshirë në krimin e organizuar”, sipas përcaktimeve të nenit dh të Aneksit të Kushtetutës, pikës 15 të nenit 3 dhe kritereve të tjera të neneve 34 e 38 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në zbatim të këtyre dispozitave ligjore, mungesa e këtyre të dhënave konkrete mbi rrethin e personave dhe natyrën e veprimeve e të kontakteve të kandidates me ta në vitet 2001 e 2002, të sjellin në përfundimin se nuk mund të vendoset ndalimi i kandidimit.

Gjithsesi, këto të dhëna të përcjella zyrtarisht nga organet kompetente dhe të administruara gjatë procedurës së verifikimit të kandidaturës lidhur me kushtet ligjore të kandidimit për figurën dhe integritetin e kandidatit, janë vënë në bisedim nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në procesin e diskutimit dhe të shprehjes së qëndrimeve të anëtarëve të këtij Këshilli mbi vlerësimin dhe pikëzimin e kandidates Marsida Xhaferllari.

Ndonëse të informacionet dhe të dhënat zyrtare të deklasifikuara të sipërcituara të agjencive ligjzbatuese të përcjella pranë KED nga ana e DSIK, u vlerësuar nga ky Këshill si të pamjaftueshme dhe jo të plota për të ardhur në përfundimin se mbi bazën e tyre mund të vendoset ndalimi i kandidimit, gjithsesi ato janë të dhëna dhe burime informacioni të cilat mund dhe duhet të mbahen parasysh nga Këshilli në procedurën e vlerësimit dhe pikëzimit të kandidaturës kur shqyrtohen meritat e morale të kandidaturës së kandidates Marsida Xhaferllari. Vërtetësia ose jo ne thelb e informacioneve të organeve të tjera nuk është objekt

shqyrtimi i KED por i vetë institucioneve që i kanë lëshuar ato. Për më tepër në rastin e akteve të DSIK, KED e ka të pamundur të verifikojë vërtetësinë ose jo të informacioneve të këtij institucioni për aq kohë sa burimi i tyre konsiderohet sekret nga vetë organi, që e ka përcjellë këtë informacion.

Për këto arsye, sjelljet dhe veprimet e sipërcituara e atribuuara kandidatës Marsida Xhaferllari, në informacionet e dërguara nga organet kompetente ligjzbatuese, janë të tilla që duhet të kualifikohen si mosrespektim i parimeve të gjithëpranuara mbi etikën dhe integritetin e gjyqtarit të trajtuara hollësisht në vendimin normativ të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 5 datë 02.04.2019 “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, dhe në Metodologjinë për Vlerësimin dhe Caktimin e Pikëve për Renditjen e Kandidatëve për Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019 nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në zbërthim të kriterëve të vlerësimit të kandidaturave të parashikuara në nenin 125 të Kushtetutës, nenin 7/a të ligjit nrë 8577/2000 dhe nenin 240 të ligjit nr.115/2016.

Për sa i përket kriterit vlerësues të integritetit etik dhe moral, sjelljet dhe veprimet e sipërcituara të atribuuara kandidatës Marsida Xhaferllari, në informacionet e dërguara nga organet kompetente ligjzbatuese, janë të tilla që nuk përputhen me respektimin e:

- a) *Detyrimin të ndershmërisë, korrektesës dhe respektit të gjyqtarit*, aq më tepër të atij/asaj që kandidon të jetë gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilave kandidati duhet të ushtrojë dhe të ketë ushtruar (në të kaluarën) funksionet profesionale pa favorizim, të refuzojë të pranojë çfarëdo dhurate ose avantazhi për veten ose për ata që janë pranë tij/saj, kur ushtron funksionin e gjyqtarit ose profesion tjetër etj.,
- b) *Detyrimin për respektimin e nderit dhe të dinjitetit të gjyqtarit*, pra që në sjelljen dhe veprimtarinë e tij/saj të sigurojë që, nëpërmjet praktikës së tij/të saj profesionale dhe të jetës e të personit të tij/të saj, ai/ajo nuk ka cenuar dhe nuk rrezikon të cenojë imazhin dhe figurën publike të gjyqtarit, gjykatës dhe të sistemit të drejtësisë,

Për rrjedhojë, këto përfundime, detyrimisht reflektohen në vlerësimin dhe pikëzimin e ulët për këtë kandidatë lidhur me “meritat morale”, më konkretisht lidhur me kriterin vlerësues të integritetit etik e moral.

Gjithashtu, për të njëjtat arsye të lidhur me informacionet dhe të dhënat e sipërcituara që përmban dosja e kandidimit, veçanërisht atyre që janë shqyrtuar dhe administruar në procedurën e verifikimit të plotësisht të kushteve ligjore mbi figurën dhe integritetin për lejjimin e kandidimit, sjelljet dhe veprimet e atribuuara kandidatës Marsida Xhaferllari të sjellin në përfundimin që kandidaturës i mungojnë elementët qoftë edhe të mjaftueshëm të kërkuar nga ligji, parimet dhe standardet e gjithëpranuara të *reputacionit që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve*, si njëri ndër elementët e “meritave morale”, aq më tepër për të ushtruar funksionin kushtetues të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese. Reputacioni ndërtohet jo vetëm mbi aftësitë profesionale por edhe mbi integritetin e shfaqur në përmbushjen e veprimtarive profesionale.

Nga ana tjetër, Këshilli nuk mund të mos mbajë parasysh që reputacioni nuk ndërtohet dhe konsolidohet vetvetiu thjesht për shkak të ushtrimit të disa funksioneve dhe detyrave publike, përfshirë edhe atë të Kryeinspektores së KLD që ka ushtruar kandidatja Marsida Xhaferllari. Për rrjedhojë, edhe reputacioni i kësaj candidateje nuk mund të vlerësohet i shkëputur nga niveli i ulët i besimit publik dhe opinionet kritike në sistem dhe shoqëri lidhur me veprimtarinë e këtij institucioni, as nuk mund të shikohen të shkëputura nga mospërmbushja në tërësi e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore dhe nga mungesa e thellë e besimit publik në institucionet

e sistemit të drejtësisë, përfshirë KLD dhe Inspektoratin e tij, që përbëjnë edhe disa nga motivet kryesore të nismës dhe realizimit të Reformës në Drejtësi të finalizuar me miratimin e ndryshimeve kushtetuese dhe të ligjeve të reja për sistemin e drejtësisë.

Edhe vendimi nr. 115 datë 11.03.2019 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ndonëse nuk ka marrë formë të prerë sepse është ankimuar nga subjekti i rivlerësimit, evidenton një numër çështjesh të lidhura me angazhimin dhe korrektësinë në respektimin e zbatimin e ligjit për statusin e gjyqtarit nga ana e kandidatës Marsida Xhaferllari përpara dhe pas miratimit të legjislacionit të Reformës në Drejtësi të vitit 2016, çështje të cilat vlerësojmë se kanë lidhje dhe ndikim edhe në reputacionin e kandidatës.

Së fundi, një pjesë e rëndësishme e reputacionit të kandidatit lidhet me përceptimin. Në krijimin e këtij përceptimi ndikon edhe mënyra se si kandidatja ka komunikuar me Këshillin, duke paragjykuar dhe anatemuar punën e tij, kryesisht në shkresën e datës 16.07.2019. Citoj ndër të tjera *“Ajo që realisht më shqetëson është instrumentalizimi i KED-së dhe zhvillimi i një procesi të parregullt dhe persekutues më qëllimin e montimit të një pengese inekzistente të kandidimit tim për të më eliminuar padrejtësisht nga konkurrimi, duke u bazuar nga konsiderata të të tretëve që ndikojnë në procesin, që me Kushtetutë duhet të administrohet nga KED”*.

Për rrjedhojë, këto përfundime, detyrimisht reflektohen në vlerësimin dhe pikëzimin e ulët për këtë kandidatë lidhur me “meritat morale”, më konkretisht lidhur me kriterin vlerësues të reputacionit që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve, integritetit etik e moral.

ANËTARI I KED

Arta Marku



ANËTARI I KED

Ardian Dvorani

